



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-25444/22
Kaçanik, 19.09.2022

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në katin e dytë të objektit të komunës, në sallën e komiteteve të kuvendit, me 26 shtator 2022 (e Hënë), më fillim pune në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e VIII (Tetë) të Rregullt të KPF-s të datës 26.09.2022, do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024- 2025;
3. Draft Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr. 02-60/01-4863/20 datë 06.07.2020 për Taksat Komunale;
4. Propozim Vendimi për Transferin e mjeteve buxhetore;
5. Propozim Vendimi për lejimin e mjeteve për subvencionim të fermerëve;
6. Propozim Vendimi për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-16843/22
Kaçanik, 22.06.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 korrik 2022. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin fillimisht ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani dhe Rabiye Sallahu, në ndërkohë arriti edhe Fitore Vishi, kështu që pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin 7 anëtarë.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Pranvera Loku-Zharku, Suhad Dullovi.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune për me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të KPF-a për vitin 2022, data, 25 korrik, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2022;
3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve;
4. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë;
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Raporti i punës së KKSBB për gjashtë mujorin e parë 2022;

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e

APROVON

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikëve.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ka kush ndonjë vërejtje lë të urdhëroj. Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri nga 6 anëtarët të cilët ishin prezentë në këtë pikë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

APROVON

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të datës 22.06.2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-16843/22.

2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti i shpenzimit të buxhetit, bëhet në çdo tre muaj, drejtori është këtu, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e, **Diskutoj Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2022. Ky raport financiar i kalohet KK në procedurë për diskutim.**

3. Propozim Vendim për transferin e mjeteve;

Kryesuesi i Kuvendit: Materiali e keni marrë se bashku me arsyetimin, nëse ka kush diçka, hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kërkoj një sqarim nga drejtori i financave lidhur me kontratën për ndërtimin e çarshisë së vjetër?

z. Bahri Selimi: Kontrata për ndërtimin e çarshisë së vjetër, është lidhur me 291.000€, në vitin e kaluar janë shpenzuar 153.000 €, një pjesë planifikohet sivjet e kemi 200.000 €, 130.000€ me u lidhur kontrata, veç atë pjesën e gramtit, 170.000 €, nuk mundem me hequr mjetet që mbesin, kemi drejtë 15% me bërë kursime, këto mundem me i transferuar të mallrat dhe shërbimet të e njëjta drejtori për shkak se një projekt që e kemi pasur, fasadimi i objekteve banesore u kanë investim kapital, ministria na e ka hequr, që projekti me u realizuar me mallra dhe shërbime. Këto mjete dalin të mallrat e shërbimet dhe bëhet fasadimi i objekteve.

z. Agim Mani: A ka filluar me u ndërtuar ky projekt?

z. Bahri Selimi: Projekti është në proces të fillimit të realizimit. Kontrata kur është lidhur ne e patëm aprovuar buxhetin, pasi ka pasur nevoja tjera, kemi pasur mundësi me i ri destinuar, ndërkaq jemi në hendikep që nuk po kemi rishqyrtim të buxhetit. Kështu po i shfrytëzojnë këto mundësitë tjera e sidomos kjo ngritja e çmimeve komunave iu ka sjellë probleme se kemi inflacion, 1m dru është blerë 40€, tani 80 €, pastaj pajisje tjera si shëndetësi e arsim, që është dyfishuar rritja e çmimit të produktit. Sigurimi i objekteve fizike, tani me pagën minimale që pritet të ndodhë, neve na rritet kostoja për shkak të inflacionit, ndërkaq buxheti mbetet i njëjtë.

z. Kadrije Lika-Troni: Nëse ke mundësi drejtor me na sqaruar shumën 20.000€ dhe shumën e ndryshuar 25.000€ të ky propozim vendim.

z. Bahri Selimi: Të mallrat dhe shërbimet DUKMM i ka 20.000 €, shtohen 25.000 € dhe bëhen 45.000 € si buxhet i mallrave. Këto shuma shkojnë të mallrat dhe shërbimet, ndërkaq janë hequr nga investimet kapitale.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit t'i shkoj KK ky propozim Vendim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për transferin e mjeteve. KPF këtë pikë ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë;

Kryesuesi i Kuvendit: Është e drejtë ekskluzive e KK me marrë vendime të tilla, komuna përcaktohet me pronat që i jep në shfrytëzim nga vlera e investimeve. Ligji e përcakton qartë si jepen në shfrytëzim pronat komunale në procedurë afatgjatë 1- është vlera e investimit, 2- është numri i punëtorëve, 3- është përfitimi ekonomik i komunës. Komuna përcaktohet në bazë të kërkesave të investitorëve të ndryshëm. Ky është vendim paraprak, pastaj formohet komisioni vlerësues, i cili e harton ankandin publik në bazë të ligjit dhe rregullores, duke u bazuar në kushte dhe kriteret, që mund të konkurrojnë investues nga brenda apo nga jashtë dhe bëhet përzgjedhja-vlerësimi i komisionit, i cili del në KK. Ky është vendim paraprak për me hapur rrugën e mëtejme, ndërkaq vendimin përfundimtar e merr KK. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika- Troni: Kush i vendosë kriteret për caktim të afatit kohor?

Kryesuesi i Kuvendit: Kriteret vendosen në Propozim Vendim, kriteret veç janë të përcaktuara edhe afatet kohore. Komuna në bazë nevojave dhe kërkesave, rëndësisë së pronave, vendosë afatet e dhënies në shfrytëzim. Komisioni e jep vlerësimin, përcaktues është DUKMM dhe DZHE, të cilët merren me hulumtimin e kërkesave dhe nevojave që paraqitën. Komisioni e ka statusin vlerësues të ofertave. Hapjen e ankandit, iu përmbahen kushteve dhe kriteret të përcaktuara në ligj dhe rregullore e jep vlerësimin dhe e dërgon në KK për miratim. Konkurrentët kanë të drejtë ankese për ata formohet komisioni i ankesave me shikuar se a ka vepruar drejtë komisioni vlerësues. Komisioni i ankesave e bënë një raport dhe lënda vjen në KK.

z. Agim Mani: Konkurruesit a shkojnë përmes kërkesave apo përmes ankandëve publike? Për secilën parcelë që epët, a merret parasysh kategorizimi i pronës, p.sh. nëse është bujqësore me u dhënë për atë destinacion e jo me u shndërruar në tokë ndërtimore.

Kryesuesi i Kuvendit: Komuna e përcakton planin se cilat parcela i ka në dispozicion me i dhënë në shfrytëzim. Kjo është e përcaktuar në fund të vitit të kaluar. Komuna e ka hulumtuar terrenin, është përcaktuar për pronat që mund të jepen në shfrytëzim afatshkurtër apo afatgjatë. Sipas ligjit, kërkohet që komuna r 'i ketë të listuar 1 vit me herët pronat që do t'i jep në shfrytëzim. Këto prona jepen në shfrytëzim në bazë të kërkesave të investitorëve, komuna në bazë të nevojave dhe kërkesave përcaktohet se cilat prona do të jepen në shfrytëzim. Kjo del në ankand publik, ndërkaq ankandit kanë të drejtë të konkurrojnë kushdo nga brenda dhe jashtë. Kushtet dhe kriteret janë të përcaktuara në bazë të vlerës së investimit dhe numrit të punëtorëve. Varësisht nga rëndësia e pronës, është edhe vlera e investimit.

z. Agim Mani: Unë të toka bujqësore po e marrë shembull, nëse prona është bujqësore kullosë e klasës 4, a lejohet me bërë afarizëm në tokë bujqësore, pa ia ndërruar destinimin pronës.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që i jepet në KK prona në shfrytëzim, me një plan konkurrues, pavarësisht klasës, atij i lejohet ndërrimi i destinimit të tokës edhe pse kërkesën e bënë

për ndërrim destinimi. Me atë vendim të KK që i jepet prona në shfrytëzim fjala vjen, për ndërtimin e një fabrike, automatikisht i lejohej edhe ndërrimi i destinimit të tokës, për shkak se ajo paraqet një zhvillim ekonomik që ne po e kërkojmë dhe me vendim të KK kur është me plan konkurrues, komuna ka të drejtë me dhënë në shfrytëzim tokën për veprimtari të ndryshme. Ligji e lejon që toka të jepet në shfrytëzim për investitor të lëmit të ndryshme. Në momentin që vendimi 2 herë kalon në KK, me duket nga legjislatura e kaluar që janë marrë me këto çështje, me atë procedurë është kryer edhe ndërrimi i destinimit, vetëm i kanë paguar taksat dhe kanë vazhduar me obligimet tjera.

z. Kadri Krivenjeva: Sa i kuptoj pyetjen e Agimit, qysh me dhënë tokën bujqësore për ndërtim, megjithatë aty janë do kritere do vlerësime, nëse vlera investive është milionëshe, atëherë vlera investive e kalon vlerën e tokës bujqësore.

z. Agim Mani: Nga praktikat e mëhershme, ku iu është ndërruar destinimi tokës, nëse është mundësia në start ajo që është tokë bujqësore me u dhënë në shfrytëzim për investime në bujqësi, asaj me i dhënë prioritet.

Kryetari i Komunës: Meqenëse ligji për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të tokës së komunës, i definon çështjet pak a shumë dhe nuk ka me pasur nevojë për ndërrim destinimi. Shembull konkret është autostrada, e ka marrë tokën e klasës të parë se ka qenë interes nacional. Edhe këtu kur mendohet se dhënia në shfrytëzim e një prone komunale është interes për ndërtimin e një fabrike, se interesi i komunës dhe i shtetit është me i madh sesa vlera e asaj toke. Vendimi shkon në MAPL, nëse nuk është në rregull, na e tërheqë vërejtjen e na tregon se bien ndeshë me ligjin. Ligji përcakton edhe kriteret për dhënien e pronave në shfrytëzim për 15, 45 vjet dhe 99. Komisioni i vlerëson dhënien në shfrytëzim, pastaj nëse ka ankesa është komisioni i ankesave që i vlerëson ato.

z. Agim Mani: Unë e di se ka pasur raste kur është dhënë toka në shfrytëzim, pastaj është marrë me qira.

Kryetari i Komunës: Ato që po i thoni, janë në nivel vendi me AKP. Besoj se nëse ka pasur raste të tilla, kanë pësuar prej asaj.

Kryesuesi i Kuvendit: Ato prona që janë dhënë nga AKP, ne nuk jemi kompetent dhe nuk e dimë se çka ka ndodhur. Në rast se që është dhënë toka në shfrytëzim, është e ndaluar me ligj të epët me qira, toka që epet në shfrytëzim nga komuna në një nen të ligjit thuhet se, nuk mund të tjetërsohet nga komuna, se nëse nuk e shfrytëzon vet, bëhet raporti dhe i merret e drejta e shfrytëzimit. Nëse duhet me ia dhënë dikujt tjetër në shfrytëzim, e jep komuna e jo ai që e ka marrë në shfrytëzim. Diskutime tjera nuk ka, a jeni që ky propozim vendim të shkoj në KK Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimin Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Afatgjatë. Këtë pikë KPF ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: Formimi i komisionit vlerësues është e drejtë ekskluzive e KK. E hapi diskutimin, nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Këtë pikë KPF ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Formimi i këtij komisioni me duket pak i hershëm, se ende pa u dhënë pronat komunale në shfrytëzim formohet komisioni. Është mirë komisioni i ankesave të formohet pas vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues. Komisioni i ankesave e bënë vetëm shqyrtimin e një ankese.

Kryesuesi i Kuvendit: Komisioni i ankesave duhet të formohet, se nëse nuk e formojmë, atëherë duhet thirret një mbledhje për këtë pikë. Nuk ka kurrfarë problemi nëse formohet komisioni dhe ai pritë kur ka ankesa.

Kryetari i Komunës: Komisioni pa i ankesa nuk punon, kur ka ndonjë ankese atëherë e merr në shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni t'i shkoj KK ky propozim vendim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Këtë pikë KPF ia

Rekomandon

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

7. Raporti i punës së KKSB për gjashtë mujorin e parë 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Këtë këshill e udhëheq Kryetari i Komunës. Me intereson të di, rekomandimet, nga 3 mbledhje të mbajtura deri tani, janë nxjerrë rekomandime të ndryshme, shihet se procesi monitorohet prej OSBE. Pyetja është. sa po gjejnë zbatim rekomandimet, se po janë të ndryshme dhe të natyrave të ndryshme, sepse në raport nuk po e shoh se është shënuar sa janë zbatuar rekomandimet.

Kryetari i Komunës: KKSB është këshillëdhënëse, të gjitha propozimet që dalin, ngase kemi prezent nga OJQ, etj. ato që janë në domenin e komunës janë të zbatueshme, ndërkaq pjesa e të cilave nuk është në domenin e komunës, po mundohemi me apele me rekomandime të ndryshme. Rekomandime ka me tepër të dhuna, qoftë në familje apo shoqëri. Në për këtë mundohemi me i rekomanduar komandantit të policisë me dërguar me shpesh patrulla ku ka frekuentime. Ne kemi kërkuar edhe në shkollë, por mundësitë dhe kapacitetet e zyrtarëve kanë qenë të mangëta me monitoruar. Ne po dalim me rekomandime, por zbatimi i tyre në mungesë të kapaciteteve nuk ndodhë çdo herë. Gjatë 1 viti ky këshill mban 6 takime, 3 në gjashtëmujorin e parë, përpara është raportuar 1 herë, tani është 2 herë në vit.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në lokacionin të Dardha që po bëhen ndeshje shpesh, nuk është rekomanduar që patrulla e policisë me qenë aty vazhdimisht, se aty është unaza që e lidhë komunën e Kaçanikut me fshatrat. Unë e shoh të arsyeshme me bërë një kërkesë që në atë vend me pasur patrollë të policisë vazhdimisht, se shkaku i shpejtësisë të kyçja ç kyçja e autostradës po ndodhin aksidentet në atë pjesë.

Kryetari i Komunës: Kjo çështje nuk është ngritur deri tani. Kërkesa e juaj është e arsyeshme, janë diku 60 policë me tre ndërrime. Është e pamundur me pasur patrollë të vazhdueshme të policisë në atë pjesë. Për me kërkuar me shpesh patrollë apo ndëshkime të asaj pjese me qenë me të kujdesshëm vozitësit, është vështirë me gjetur formën, sepse kërkohet patrollë për pyjet, inspektorët kur dalin në terren kërkojnë me pasur mbështetje të policisë, kështu është e pamundur me pasur pikë stacionuese të policisë 24 orë. Megjithatë unë kam me ngritur në emrin tënd, por është problem me pasur pikë stacionuese me numrin e policëve që janë. Kur e kemi bërë ruajtën e pyjeve, pas orarit të punës me orë shtesë, për ndryshe ka qenë e pamundur.

znj. Kadrije Lika-Troni: Me pasur shenja sinjalizuese, se kjo pa na kushton me humbje jete, se shumë raste të aksidenteve kanë ndodhur.

Kryetari i Komunës: Me vendosur shenja sinjalizuese është mirë, megjithatë çdo vozitës e dinë shpejtësinë e lejuar. Kemi kërkesa të mëdha të qytetarëve që kërkojnë pengesa në rrugë lokale. Kjo nuk është e arsyeshme, formën qysh me gjetur me i vetëdijesuar qytetarët, nuk jemi duke mundur me gjetur. Ndëshkohen mjaft shumë në bazë të tiketave, duhet me apeluar vazhdimisht të qytetarët për një vetëdijesim, sepse po rrezikohet jeta e fëmijëve tanë e në përgjithësi jeta e qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni që raporti t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF, **Diskutoj Raportin e punës së KKSB për gjashtë mujorin e parë 2022. Ky raport pune i procedohet Kuvendit të Komunës për diskutim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:36. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28 Korrik 2022 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli